



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:006675

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05620277

P.nr.281/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarit D. H. i akuzuar për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 dhe B. I. i akuzuar për veprat penale Sulmi nga neni 184 par 2 lidhur me par 1 dhe Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.275/20 të datës 25.06.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 08.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Blerim Igrishta dhe të akuzuarit B. I., me datë 08.04.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 25.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. I., i biri i J..... dhe nëna M....., e gjinisë R....., i lindur me, në L.... KK M....., me vendbanim në L..... KK M....., me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datën 19.01.2020 rreth orës 13:00 në rrugën “R... M.... “në F.... K.... i pandehuri B. I. pasi që ishte fjalosur dhe rrahur me të pandehurin D. H. me dashje e ka sulmuar fizikisht me një çekan mjet I përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore si deh me atë rast me çekan e ka dëmtuar veturën e të dëmtuarit B. K..

- Me këtë ka kryer veprën penale *Sulmi* nga neni 184 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe veprën penale *Asgjësimit apo dëmtimit i pasurisë* nga neni 321 par 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 69, 70, 71, 72 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarin i:

Përcakton

- I. Për veprën penale Sulmi nga neni 184 par 2 lidhur me par 1, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj.
- II. Për veprën penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par 1, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj.

Ne kuptim të nenit 76 par 2 pika 2.4 të KPRK-së, gjykata të akuzuarin e:

GJYKON

- I. Me dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbaj nëse në afat prej 2 (dy) viteve nuk kryen veprë të re penale.
- II. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 60 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. I dëmtuari B. K për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzë PP/II.nr.275/20 të datës 25.06.2020, ndaj të akuzuarve D. H. i akuzuar për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 dhe B. I. i akuzuar për veprat penale Sulmi nga neni 184 par 2 lidhur me par 1 dhe Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par 1 të KPRK-së.

Gjykata pas dëgjimit të palëve në procedurë, ndaj të pandehurit D. H. ka veçuar procedurën penale pasi që i njëjti nuk është arritur që të sigurohet përkundër disa tentimeve për të siguruar prezencën e tij në gjykatë andaj me qëllim të ekonomizimit të procedurës e në harmoni me nenin 35 par 1 dhe 2 të KPRK-së Gjykata në këtë çështje penale ka zbatuar procedura të ndara ndaj të pandehurve duke marrë për bazë edhe faktin se vepra penale është kryer nga secili i pandehur veç e veç.

Gjykata, në çështje penale ndaj të pandehurit B. I. ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 08.04.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit, Blerim Igrishta dhe të akuzuarit ku i njëjti u njoftuan me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij.

Seanca ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga prokurori i shtetit ku pas leximit të saj i pandehuri u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurit dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga

neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarinimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarinimit të akuzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit B. I qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Sulmi nga neni 184 par 2 lidhur me par 1 dhe Asgjësim apo dëmtim I pasurisë nga neni 321 par 1 të Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-74.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën penale me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarit, ndërsa rrethana rënduese nuk janë konstatuar nga Gjykata.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 48 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë.

Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL

P.nr.281/24 datë 25.04.2024

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.